



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06

**Vendosi:** Kryetarja e Dhomave të Specializuara  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 24 gusht 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

## Vendim mbi kërkesën për vetëtërheqje të Kryetares

---

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**

Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hashim Thaçit:**

Gregori Kihou

**Mbrojtësit të viktimave:**

Sajmon Loz

**Mbrojtësit të Kadri Veselit:**

Ben Emerson

**Mbrojtësit të Rexhep Selimit:**

Dejvid Jang

**Mbrojtëses të Jakup Krasniqit:**

Venkatesvari Alagendra

**KRYETARJA** e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke marrë parasysh nenet 32(3) dhe 33 të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), rregullat 13(1)(a)-(c), (e), 20(1)-(3) dhe 82(3) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht “Rregullorja” dhe “DHSK”) dhe rregullat 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin”), nxjerr këtë vendim mbi kërkesën e z. Hashim Thaçi (“i akuzuari”) për vetëtërheqje të Kryetares (“Kërkesa”).<sup>1</sup>

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 23 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori vendimin mbi rishikimin e paraburgimit të z. Thaçi, në të cilin ai urdhëroi, *ndër të tjera*, vazhdimin e paraburgimit të tij. (“Vendimi mbi paraburgimin”).<sup>2</sup>

2. Më 28 korrik 2021, Mbrojtja parashtroi kërkesën për zgjatje të afatit për të apeluar vendimin mbi paraburgimin (“Kërkesa për zgjatje të afatit”).<sup>3</sup>

3. Më 29 korrik 2021, Kryetarja caktoi Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur mbi kërkesën për zgjatje të afatit (“Vendimi për caktimin e panelit”).<sup>4</sup> Në vendimin për caktim, Kryetarja, pasi shqyrtoi parimet dhe kriteret e përcaktuara në rregullën 4 të Rregullores për Caktim, “përfshirë edhe kompetencën dhe përvojën përkatëse si dhe disponueshmërinë [e gjykatësve] në këtë kohë”, caktoi gjykatësit Mishelë Pikar, Emilio

---

<sup>1</sup> F00434, Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për vetëtërheqjen e Kryetares Ekaterina Trendafilova nga caktimi i Panelit të Gjykatës së Apelit për gjykimin e apelit të z. Thaçi lidhur me lirimin përkohshëm me shtojcën 1 dhe shtojcën publike 2, 16 gusht 2021.

<sup>2</sup> F00417/RED, Version i redaktuar publik i rishikimit të paraburgimit të Hashim Thaçit, 23 korrik 2021, para. 64.

<sup>3</sup> IA010/F00001, Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për zgjatje të afatit për parashtrim të apelit kundër vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi rishikimin e paraburgimit të Hashim Thaçit, 28 korrik 2021.

<sup>4</sup> IA010/F00002, Vendim për caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit për shqyrtim të kërkesës lidhur me afatet, 29 korrik 2021.

Gati dhe Nina Jorgensen për të vendosur lidhur me kërkesën për zgjatje të afatit.<sup>5</sup>

4. Më 16 gusht 2021, Mbrojtja parashtrori apel kundër vendimit mbi paraburgimin (“Apeli kundër vendimit mbi paraburgimin”).<sup>6</sup>

5. Mbrojtja parashtrori kërkesën në të njëjtën ditë.

## II. DISKUTIM

6. Fillimisht, Kryetarja rikujton se ajo vendosi lidhur me një kërkesë të ngjashme për vetëtërheqje/heqje në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt* (“Vendimi mbi kërkesën për heqje”), në të cilin, bazuar në analizën e teksteve juridike dhe jurisprudencës përkatëse, u vendos se ajo është kompetente për të marrë vendim në lidhje me kërkesën.<sup>7</sup> I njëjti argumentim dhe përfundim vlen edhe për kërkesën aktuale.

### A. Dorëzimi brenda afatit i kërkesës

7. Në kërkesë Mbrojtja e z. Thaçi argumenton se:

Kërkesa aktuale [Kërkesa] për vetëtërheqje u parashtrua në kohë, pavarësisht se informacioni kishte qenë në dispozicion më parë, sepse Kryetares mund t'i kërkohej vetëtërheqja nga përmbushja e një roli gjyqësor sipas rregullës 20(1) vetëm kur ajo ushtron funksion gjyqësor në atë çështje gjyqësore. Ushtrimi i funksionit gjyqësor nga Kryetarja në çështjen gjyqësore aktuale filloi me parashtrimin e apelit të z. Thaçi për lirim të përkohshëm, i cili u parashtrua në të njëjtën kohë me këtë kërkesë.<sup>8</sup>

8. Sa i përket kohës së parashtrimit të kërkesës, Mbrojtja sugjeron se llogaritja e saj fillon nga momenti i parashtrimit të apelit kundër vendimit mbi paraburgimin. Ky qëndrim i shprehur në kërkesë është i pasaktë.

9. Sipas rregullës 20(3) të Rregullores, kërkesa për heqje duhet të parashtrohet

---

<sup>5</sup> IA010/F00002, Vendim për caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit për shqyrtimin e kërkesës lidhur me afatet, 29 korrik 2021, para. 5.

<sup>6</sup> IA010/F00004, Apelim i Mbrojtjes së Thaçit kundër vendimit për rishikimin e paraburgimit të Hashim Thaçit, 16 gusht 2021.

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-07/F00272, Vendim mbi kërkesën për vetëtërheqjen ose heqjen e gjykatësve, 6 gusht 2021.

<sup>8</sup> Kërkesa, para. 28.

“menjëherë”, dhe jo më vonë se “dhjetë (10) ditë pasi pala në fjalë të ketë marrë dijëni për arsyet mbi të cilat mbështetet kërkesa” (theksimi i shtuar). Kjo praktikisht nënkupton se “pala e interesuar [në këtë rast Mbrojtja,] vepron menjëherë sapo merr dijëni për arsyet që përbëjnë bazën e kërkesës, qoftë përmes një burimi publik ose në ndonjë mënyrë tjetër, por jo më shumë se dhjetë (10) ditë më vonë. Afati dhjetëditor tregon afatin maksimal brenda të cilit pala mund të dorëzojë kërkesën në përputhje me rregullën 20 të Rregullores”.<sup>9</sup>

10. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shtojcave të saj, është e qartë se argumentet janë bazuar në pjesëmarrjen e Kryetares në dy takime informuese diplomatike përkatësisht në dhjetor 2020 dhe shkurt 2021, si dhe në vendimin e saj për caktimin e panelit të Apelit. Sikurse e pranon edhe Mbrojtja, ajo kishte disa muaj që kishte dijëni për mbajtjen e dy takimeve informuese diplomatike.<sup>10</sup>

11. Në vazhdim, argumentet e paraqitura nga Mbrojtja i drejtohen “largimit” të supozuar nga ana e Kryetares të një gjykatësi nga Paneli i Gjykatës së Apelit. Rrjedhimisht, sipas këtij argumenti, llogaritja e afatit duhet të kishte filluar jo me apelin kundër vendimit mbi paraburgimin, por me vendimin për caktim që u lëshua 18 ditë para parashtrimit të kërkesës aktuale. Nga kjo rrjedh se kërkesa është dorëzuar jashtë afatit dhe, mbi këtë bazë, mund të hidhet poshtë. Megjithatë, Kryetarja do t’i përgjigjet pretendimeve të Mbrojtjes për hir të integritetit të procedurave para DHSK-së, transparencës kundrejt publikut dhe në interes të drejtësisë.

#### *B. Vetëtërheqja/Heqja e Kryetares*

12. Në kërkesë Mbrojtja kërkon që:

Kryetarja të caktojë Nënkyetarin për shqyrtimin e kërkesës aktuale për vetëtërheqje, në përputhje me rregullën 20(6) të Rregullores;  
Nënkyetari të caktojë një panel të përbërë prej tre gjykatësish për të gjykuar kërkesën për

<sup>9</sup> Vendimi mbi kërkesën për heqje, para. 6.

<sup>10</sup> Kërkesa, para. 27.

vetëtërheqje në përputhje me rregullën 20(3) të Rregullores; dhe Gjykatësja Trendafilova, Kryetare e Dhomave të Specializuara të Kosovës, të vetëtërhiqet nga funksioni gjyqësor konkret i caktimit të Panelit të Gjykatës së Apelit për të gjykuar kërkesën e z. Thaçi për lirim të përkohshëm, në përputhje me nenin 33(1)(c) të Ligjit për DHSK-në dhe rregullën 169 të Rregullores.<sup>11</sup>

13. Në këtë aspekt, Kryetarja thekson se në të gjithë kërkesën si dhe në masën ndreqëse të kërkuar, Mbrojtja i referohet “vetëtërheqjes” së Kryetares e jo heqjes. Vlen të rikujtohet se, në kontekstin e rregullës 20 të Rregullores, “vetëtërheqja” është një veprim që ndërmerret vullnetarisht nga një gjykatës pjesëmarrës në gjykimin e një çështjeje, kur ai ose ajo ka arsye të besojë se ekzistojnë arsye për vetëtërheqje, ndërsa “heqja” aktivizohet me kërkesën e një pale në proces.<sup>12</sup> Mbrojtja përmes masës ndreqëse kërkon, *ndër të tjera*, caktimin e panelit të përbërë prej tre gjykatësish “për të gjykuar kërkesën për vetëtërheqje”.<sup>13</sup> Megjithatë, rregulla 20(3) e Rregullores është shumë e qartë se caktimi i panelit të përbërë prej tre gjykatësish, sikurse kërkon Mbrojtja, bëhet vetëm për “të marrë vendim nëse gjykatësi duhet *hequr*” (theksimi i shtuar).

14. Pas sqarimeve më lart, duhet të theksohet se Kryetarja mund të vetëtërhiqet, në qoftë se konsiderohet e nevojshme sipas rregullës 20 të Rregullores, vetëm kur ka të bëjë me funksionet e saj gjyqësore, dhe jo me funksionet e saj administrative.<sup>14</sup> Me fjalë të tjera, në qoftë se Kryetarja do të “merrte pjesë në gjykimin e një çështjeje gjyqësore”.<sup>15</sup> Ky është rasti që përcaktohet në nenin 33(6) të Ligjit, fjalia e parë, ku thuhet “Kryetari i Dhomave të Specializuara është kryetar i trupit gjykues të çdo Paneli të Gjykatës Supreme në të cilin ai ose ajo merr pjesë”. Çdo funksion tjetër që i jepet Kryetares sipas Ligjit dhe Rregullores, përfshirë caktimi i gjykatësve në panele në pajtim me nenin 33(1) të Ligjit, përputhet me kompetencat e saj për administrim gjyqësor të rregulluar me nenet 32(3) dhe 33 të Ligjit dhe rregullës 13 të Rregullores.

---

<sup>11</sup> Kërkesa, para. 44. Shih gjithashtu Kërkesa, para. 1, 17.

<sup>12</sup> Rregulla 20(1)-(3) e Rregullores.

<sup>13</sup> Kërkesa, para. 44.

<sup>14</sup> Vendimi mbi kërkesën për heqje, para. 19.

<sup>15</sup> Rregulla 20(1) e Rregullores.

15. Dallimi midis rolit administrativ dhe gjyqësor të Kryetarit, përfshirë atë të caktimit të gjykatësve në panele, tregohet gjithashtu në nenin 33(6) të Ligjit, fjalia e dytë, sipas të cilit edhe kur Kryetari hiqet nga shqyrtimi i ndonjë çështjeje ose ka arsye të tjera për të mos marrë pjesë në ndonjë Panel të Gjykatës Supreme, Kryetarja ruan kompetencën të caktojë gjykatës për ta zëvendësuar në atë panel. Nga kjo rrjedh se, në bazë të rregullës 20 të Rregullores, Kryetarja nuk mundet të vetëtërhiqet ose të hiqet nga ushtrimi i detyrës së saj për caktimin e panelit, sikurse kërkon Mbrojtja.

16. Në këtë kontekst, Kryetarja rikujton vendimin mbi kërkesën për heqje, ku në lidhje me jurisprudencën mbi çështjen, ajo shprehet se “as Ligji e as Rregullorja nuk parashikojnë heqjen në bazë të kërkesës së një pale të Kryetares që ushtron kompetencat e saj administrative, e aq më pak ndalimin e lëshimit të vendimeve ose urdhrave të ardhshëm”.<sup>16</sup> Rrjedhimisht kërkesa mund të hidhet poshtë edhe vetëm për këtë arsye. Megjithatë, për arsyet e përmendura në paragrafin 11, Kryetarja do t’u përgjigjet pretendimeve të Mbrojtjes.

17. Përpara se të kalojë te pretendimet faktike në kërkesë, Kryetarja e konsideron të rëndësishme të trajtojë elementin në vijim të kërkesës. Në tërë kërkesën, Mbrojtja mbështetet shumë në informacionin që pretendohet se lidhet me takimet informuese diplomatike, pavarësisht se pranon që burimi i këtij informacioni është i *panjohur*.<sup>17</sup> Kryetarja rikujton se i takon palës që pretendon se ka anshmëri, që të paraqesë prova të besueshme dhe të mjaftueshme për të hedhur poshtë këtë supozim, sepse asnjë gjykatës nuk mund të hiqet nga gjykimi i një çështjeje mbi bazën e pretendimeve të përgjithshme dhe abstrakte të cilat nuk janë as të faktuara e as të hollësishme.<sup>18</sup>

### *C. Pretendimet e Mbrojtjes*

18. Pasi ka trajtuar çështjet paraprake më lart, Kryetarja tani do të kalojë tek

---

<sup>16</sup> Vendimi mbi kërkesën për heqje, para. 19, 22; jurisprudenca mbështetëse jepet në poshtëshënimin 29.

<sup>17</sup> Kërkesa, para. 31, 33.

<sup>18</sup> Shih Vendimi mbi kërkesën për heqje, para. 31 dhe citimet po aty.

pretendimet faktike. Mbrojtja pretendon se: 1) pjesëmarrja dhe deklaratat e Kryetares në takimet informuese diplomatike në dhjetor 2020 dhe shkurt 2021 ndikojnë në paanshmërinë e saj; 2) “parashtrimet *ex parte*” të Prokurorit të Specializuar në prani të Kryetares në lidhje me lirimin e përkohshëm të të akuzuarit dhe aftësinë e tij që të ndërhyjë dhe kërcënojë dëshmitarët, ndikojnë në drejtësinë e procesit dhe paanshmërinë e Kryetares;<sup>19</sup> dhe 3) vendimi i Kryetares për mosçaktimin e një gjykatësi të caktuar në Panelin e Gjykatës së Apelit që do të vendosë mbi kërkesën për zgjatje të afatit ngrenë përsëri dyshime lidhur me paanshmërinë e saj sepse “një vëzhgues objektiv do të perceptonte se ka anshmëri nëse vetëm ai largohet nga shqyrtimi i apelit të dytë të z. Thaçit për lirim të përkohshëm”.<sup>20</sup>

19. Kryetarja thekson që në fillim se nuk ka dyshim se ato takime informuese diplomatike u mbajtën. Takime të tilla nuk janë të fshehta dhe DHSK-ja ka raportuar rregullisht dhe me transparencë lidhur me to. Në këtë aspekt, Mbrojtja i referohet një përmbledhjeje të pretenduar të takimit informues diplomatik që u mbajt në dhjetor 2020 me shumicën e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, shteteve kontribuese dhe misionit të Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, që siç e ka pranuar Mbrojtja, është nga një *burim i paidentifikuar*. Mjafton të thuhet se dokumenti i këtij burimi të paidentifikuar nuk është transkriptim zyrtar i takimit informues. Në fakt, nuk ekziston një transkript i tillë dhe, për këtë arsye, vërtetësia e përmbajtjes së përmbledhjes së pretenduar nuk mund të verifikohet. Është e qartë se nuk është as transkript zyrtar e as përshkrim i saktë i përditësimit të Kryetares nga fakti që, në disa raste, dokumenti me pasaktësi i atribuon pjesë të tëra prezantimit të Kryetares dhe pasqyron në mënyrë të pasaktë atë që u tha.

20. Kryetarja rikujton se përditësimet për komunitetin diplomatik si dhe caktimi i gjykatësve në panele të caktuara i përkasin rolit të administrimit gjyqësor të Kryetares – një nga funksionet bazë që i është besuar në bazë të neneve 32(3) dhe 33 të Ligjit dhe

---

<sup>19</sup> Kërkesa, para. 2-5, 11, 16, 30-37, 41-42.

<sup>20</sup> Kërkesa, para. 9-10, 43.



rregullës 13 të Rregullores.

21. Mbrojtja parashtrohet se takime të tilla ndikojnë në paanshmërinë e Kryetares. Më konkretisht, sipas Mbrojtjes Prokurori i Specializuar, në prani të Kryetares, bëri komente lidhur me lirimin e përkohshëm të z. Thaçi dhe ndikimin e mundshëm të tij në mbrojtjen e dëshmitarëve.<sup>21</sup> Mbrojtja ankohet se kjo ndodhi “në mungesë të, dhe pa dijeninë e asnjërit prej të akuzuarve ose mbrojtësve të tyre”.<sup>22</sup> Mbrojtja në vijim thotë se Kryetarja nuk u distanca nga këto komente dhe as “nuk tha se është e papërshtatshme ose e palejueshme që një gjykatës të jetë i pranishëm”.<sup>23</sup> Për më tepër, Mbrojtja parashtrohet se këto komente “i dërgojnë [...] një mesazh Kryetares Trendafilova dhe të gjithë gjykatësve të Dhomave të Specializuara: në qoftë se guxoni të miratoni lirimin e përkohshëm të z. Thaçi, sponsorët ndërkombëtarë të DHSK-së do t’ju mbajnë personalisht përgjegjës për çdo vështirësi të hasur nga ndonjë dëshmitar”.<sup>24</sup>

22. Për të mbështetur deklaratimet e saj, Mbrojtja bazohet në kode disiplinore të ndryshme, jurisprudencën e disa juridiksioneve vendore dhe jurisprudencën rajonale të Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, si dhe në një vendim të Gjykatës Penale Ndërkombëtare mbi ndalimin e “komunikimit *ex parte*”.<sup>25</sup> Sipas Mbrojtjes, komunikimet *ex parte* janë të ndaluara “përveç kur autorizohen posaçërisht me ligj” dhe “vetëm në qoftë se pala tjetër njoftohet *post facto* pa vonesë për komunikimin”.<sup>26</sup> Sipas parashtimit, komentet e lartpërmendura, që Mbrojtja i përkufizon si “komunikim *ex parte*”, nga Prokurori i Specializuar drejtuar Kryetares e cila ishte e pranishme në takimin informues, “e njollosin pjesëmarrjen e Gjykatëses Trendafilova në sytë e një vëzhguesi objektiv, në kontekstin e lirit të përkohshëm të z. Thaçi”.<sup>27</sup>

---

<sup>21</sup> Kërkesa, para. 2-5, 30, 35-37, 41-42.

<sup>22</sup> Kërkesa, para. 30.

<sup>23</sup> Kërkesa, para. 37.

<sup>24</sup> Kërkesa, para. 2-3.

<sup>25</sup> Kërkesa, para/ 12-15.

<sup>26</sup> Kërkesa, para. 11.

<sup>27</sup> Kërkesa, para. 10-11 dhe veçanërisht 16.



23. Sugjerimi i Mbrojtjes se komentet e Prokurorit të Specializuar në prani të Kryetares gjatë takimit informues ndikojnë në paanshmërinë e saj ose të gjykatësve të DHSK-së është i paarsyeshëm dhe i pabazë.

24. Paraqitjet para misioneve diplomatike, gjatë të cilave drejtuesit bëjnë përditësime lidhur me çështje me rëndësi për secilin prej organeve, janë praktikë e zakonshme e institucioneve të tjera që financohen në mënyrë të ngjashme nga organe ndërkombëtare ose rajonale dhe/ose shtete. Këto takime standarde të përvitshme pasqyrohen në raportet vjetore të DHSK-së dhe rrjedhimisht dihen publikisht. Tjetër, DHSK-ja dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) janë dy institucione të pavarura, sikurse përcaktohet qartë në nenin 24(1) të Ligjit. Rrjedhimisht, Kryetarja nuk përfshihet dhe as nuk ka kompetenca mbi Prokurorin e Specializuar, përfshirë mbi vendimin e Prokurorit të Specializuar për t’i ofruar përditësime komunitetit diplomatik, apo mbi përmbajtjen e deklaratave të tij. Në mënyrë të ngjashme, heshtja e deklaruar e Kryetares nuk mund të kuptohet si pajtim i heshtur me Prokurorin e Specializuar. Kryetarja thjesht nuk ka nevojë të distancohet nga përditësimet e Prokurorit të Specializuar në lidhje me parashtrimet që synonte të dorëzonte ai. Veçanërisht kur ato përditësime u bënë në përputhje me kornizën ligjore të DHSK-së.

25. Gjithashtu, deklarimi se Prokurori i Specializuar ka bërë “komunikime *ex parte*” me Kryetaren është çorientues. Përditësimi i bërë nga Prokurori i Specializuar nuk iu drejtua Kryetares, dhe as nuk kishte për qëllim të kërkonte reagim ose veprim nga ana e saj; ai ishte një përditësim nga Prokurori i Specializuar drejtuar anëtarëve të komunitetit diplomatik në një takim ku ishte e pranishme edhe ajo, bashkë me Administratoren.

26. Sugjerimet e Mbrojtjes, se çdo koment i bërë nga Prokurori i Specializuar gjatë takimit diplomatik ndikon në Kryetaren dhe gjykatësit e DHSK-së dhe gjithashtu dërgon një mesazh që përbën paralajmërim për Kryetaren dhe gjykatësit në prani të

“diplomatëve (që përfaqësojnë sponsorët dhe mbështetësit financiarë të [DHSK-së]),”<sup>28</sup> në mënyrë të paarsyeshme vënë në dyshim integritetin e Kryetares dhe gjykatësve. Pretendime të tilla janë në kundërshtim me vetë themelet mbi të cilat ngrihen sistemet gjyqësore, përkatësisht pavarësia dhe paanshmëria e gjykatësve. Sikurse është konstatuar më parë, supozimi i paanshmërisë nuk mund të hidhet poshtë aq lehtë<sup>29</sup> dhe parashtrimet e Mbrojtjes në lidhje me Kryetaren nuk e përmbushin këtë standard.

27. Në këtë aspekt, Kryetarja gjithashtu rikujton në këtë aspekt se vendimet mbi rishikimin e parburgimit i shqyrton një panel i pavarur paanshmëria e të cilit merret si e qenë. Në rast dyshimi, korniza ligjore e DHSK-së përcakton procedurën për hedhjen poshtë të supozimit të paanshmërisë. Për këtë arsye, argumentet e Mbrojtjes duhet të hidhen poshtë.

28. Kryetarja gjithashtu vë në dukje jurisprudencën që ka cituar Mbrojtja,<sup>30</sup> e cila, megjithatë nuk mund të zbatohet në rrethanat aktuale. Siç u tha më lart, kur Kryetarja cakton panelin, ajo vepron në bazë të kompetencës së saj administrative, ndërsa jurisprudenca në të cilën Mbrojtja mbështetet ka lidhje vetëm me gjykatësit që ushtrojnë funksionin e tyre gjyqësor kur “marrin pjesë në një çështje gjyqësore”.

29. Mbrojtja parashtron se Kryetarja “e largoi” një gjykatës të caktuar nga Paneli i Gjykatës së Apelit, që u caktua për të vendosur mbi kërkesën për zgjatje të afatit,<sup>31</sup> duke sugjeruar se vendimi i saj “lidhej me atë se ai ishte shprehur më parë se ishte i hapur ndaj

<sup>28</sup> Kërkesa, para. 3.

<sup>29</sup> Shih Vendimi mbi kërkesën për heqje, para. 31; ICC/GJNP, *The Prosecutor v. Laurent Gbagbo and Charles Blé Goudé*, Case No. ICC-02/11-01/15, Judgment in the appeal of the Prosecutor against Trial Chamber I’s decision on the no case to answer motion, 31 mars 2021, para. 177; STL/TSL, *The Prosecutor v. Salim Jamil Ayyash*, Case No. STL-11-01/A-1/OTH/R25, Decision on Ayyash Defence Application for the Disqualification of Judge Riachy, 3 shkurt 2021, para. 8; MPNTP, *Prosecutor v. Milan Lukić*, Case No. MICT-13-52-R.1, Decision on Request for Disqualification, 28 tetor 2020, para. 11; ECCC, Case No. 002/31-10-2019-ECCC/SC (03), Decision on Khieu Samphân’s Application for Disqualification of Six Appeal Judges who Adjudicated in Case 002/01, 14 korrik 2020, para. 64; KEDNJ, *Case of Micallef v. Malta*, Application No. 17056/06, Judgment, 15 tetor 2009, para. 94; KEDNJ, *Case of Indra v. Slovakia*, Application No. 46845/99, Judgment, 1 shkurt 2005, para. 49.

<sup>30</sup> Shih Kërkesa, para. 13-15.

<sup>31</sup> Kërkesa, para. 9.

perspektivës për lirim të përkohshëm të z. Thaçi”.<sup>32</sup> Sipas Mbrojtjes, “komunikimet *ex parte*” të Kryetares “me Prokurorin e Specializuar gjatë pranisë së saj në takimet informuese diplomatike ku [Prokurori i Specializuar] bëri parashtrimet [e përmendura më lart], do ta kishin bërë një vëzhgues objektiv të besonte se largimi i një gjykatësi [të caktuar] [...] ishte i qëllimshëm”,<sup>33</sup> që ai të mos përfshihej në “shqyrtimin e apelit të dytë të z. Thaçi për lirim të përkohshëm”.<sup>34</sup>

30. Në lidhje me këtë Kryetarja rikujton se gjykatësit emërohen në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë dhe nuk caktohen në panele të përhershme. Gjykatësit caktohen në procese ose në faza procedurash gjyqësore nga Kryetarja në bazë të nenit 33 të Ligjit vetëm kur nevojiten dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në Rregulloren për Caktimin, që i jep Kryetares njëfarë diskrecioni. Detyra e gjykatësve përfundon me shqiptimin e vendimit të panelit mbi temat e caktuara *sub judice*, e jo me “largimin” e gjykatësve, siç deklaroi Mbrojtja.<sup>35</sup>

31. Kryetarja në vijim rikujton se ajo deri tani ka caktuar përbërje të ndryshme të Paneleve të Gjykatës së Apelit nga të njëjtët katër gjykatës. Pretendimi se Kryetarja e largoi një gjykatës të caktuar qëllimisht është në kundërshtim me praktikën ekzistuese.

### III. PËRFUNDIM

32. Duke marrë parasysh sa më lart, kërkesa për vetëtërheqje ose heqje të Kryetares dhe caktimi i nënkryetarit për shqyrtimin e kësaj kërkesë në pajtim me rregullën 20(6) të Rregullores duhet të hidhet poshtë. Duke qenë se Kryetarja nuk është objekt i vetëtërheqjes dhe heqjes në pajtim me rregullën 20 të Rregullores për ushtrimin e rolit të saj administrativ gjyqësor, ajo vazhdon të ketë kompetencë në ushtrimin e funksioneve të saj në përputhje me kornizën ligjore të DHSK-së. Nga kjo rrjedh se masa e dytë dhe e

---

<sup>32</sup> Kërkesa, para. 10.

<sup>33</sup> Kërkesa, para. 10.

<sup>34</sup> Kërkesa, para. 43.

<sup>35</sup> Shih nenin 30(3) të Ligjit.

tretë ndreqëse, që kanë të bëjnë me caktimin nga nënkryetari e një paneli të përbërë prej tre gjykatësish për të gjykuar kërkesën dhe vetëtërheqjen e Kryetares nga caktimi i Panelit të Gjykatës të Apelit gjykimin e apelit kundër vendimit mbi paraburgimin duhet të hidhet poshtë gjithashtu.

#### IV.VENDIM

33. Për arsyet e lartpërmendura, Kryetarja:

- a) **HEDH POSHTË** kërkesën në tërësi në përputhje me paragrafin 32 të këtij vendimi; dhe
- b) **URDHËRON** Administratoren ta riklasifikojë si publike kërkesën (F00434).

\_\_\_\_\_  
/nënshkrim/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,**  
**Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E enjte, 24 gusht 2021  
Në Hagë,  
Holandë